



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 9.3.2022, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për zbatimin e lehtësirave të ndërsjella në procedurat doganore dhe/ose të kontrollit të hyrje-daljes së mallrave” (*Komision për dhënie mendimi*)

2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile dhe tregtare” (*Komision për dhënie mendimi*)

3. Shqyrtimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e pjeshme të zgjeruar për rrugët kulturore, miratuar me rezolutën CM/RES (2013) 66” (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Etjen Xhafaj, Petro Koçi, Besion Ajazi, Benet Beci, Tomor Alizoti, Hatixhe Konomi, Lavdrim Krashi, Tritan Shehu, Ilirjan Pendavinji, Belind Këlliçi, Kreshnik Çollaku, Blendi Klosi dhe Greta Bardeli.

Mungojnë:

Blendi Klosi, Grida Duma, Alqi Bllako, Shpëtim Idrizi, Klodiana Spahiu dhe Vangjel Dule.

Të ftuar:

Besart Kadia – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë.

Elira Demiraj – Drejtoreshë e Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Arjana Dymishi – Drejtoreshë e Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Ekonomik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Enkeleda Hitaj – Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Procedurave Doganore (DPD) në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Vjosana Neziri – Drejtoreshë Juridike në Drejtorinë e Procedurave Doganore (DPD) në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Klajd Karameta – Zëvendësministër i Drejtësisë.

Besmir Beja – Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë.

Diana Stillo – Eksperte Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë.

Meri Kumbe – Zëvendësministre e Kulturës.

Anila Muka – Drejtoreshë e Drejtorisë së Integrimit në Ministrinë e Kulturës.

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme të datës 9.3.2022.

Sot në rendin e ditës kemi: shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për zbatimin e lehtësirave të ndërsjella në procedurat doganore dhe/ose të kontrollit të hyrje-daljes së mallrave”, për të cilin jemi komision për dhënie mendimi dhe relator do të jetë kolegu Klosi, më pas atë “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile dhe tregtare”, për të cilin jemi komision për dhënie mendimi dhe relator do të jetë kolegu Beci, si dhe shqyrtimin e projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e pjesshme të zgjeruar për rrugët kulturore, miratuar me rezolutën CM/RES (2013) 66”, për të cilin, gjithashtu, jemi komision për dhënie mendimi dhe relator do të jetë kolegu Krashi.

Për pikën e parë, kemi të ftuar... Nuk e shoh të jetë prezent zëvendësministri Kadia. Ka ardhur? Jo? Arsyet pse nuk ka ardhur zoti Kadia? Nuk dihen arsyet. Në rregull.

Ndërkohë, të ftuar kemi zonjën Demiraj, drejtoreshë të Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit. Nuk është?

Paskemi edhe zonjën Dyrmishi, drejtoreshën e Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Ekonomik. Mirë se vjen, zonja Dyrmishi, është kënaqësi që të shikoj pas kaq kohësh, si një eksperte e mirë e çështjeve!

Prezente kemi edhe zonjat Hitaj dhe Neziri, të cilave gjithashtu u uroj mirëseardhjen!

Atëherë, fillojmë pa humbur kohë, zonja Dyrmishi, dy fjalë rreth projektligjit të parë.

Arjana, fjala për ju. Mund t’ia lejoj vetes të të thërras në emër, meqenëse njihemi prej kohësh.

Arjana Dyrmishi – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Sot kemi paraqitur për miratim në parim draftmarrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës lidhur me zbatimin e lehtësirave të ndërsjella në procedurat doganore dhe/ose të kontrollit të hyrje-daljes së mallrave.

Prej një kohe të gjatë kemi bashkëpunime të ndryshme dhe marrëveshje të ndryshme me palën kosovare në fusha të ndryshme, të cilat synojnë thjeshtimin e procedurave doganore të operatorëve tanë, si ato për procedura importi, ashtu edhe ato të eksportit në të dyja vendet. Aktualisht funksionon zyra doganore e kalimit transit në Porto Romano në Durrës.

Synimi i kësaj marrëveshjeje është specifik dhe synon më në detaje thjeshtimin e procedurave doganore, lehtësimin e kohës së kryerjes së procedurave në import dhe në eksport për operatorët tanë në të dyja palët.

Një risi e kësaj marrëveshjeje ka të bëjë me mundësinë e hapjes së zyrave doganore, kryesisht me fokus produktet fruta dhe perime, njohjen e përbashkët të licencave lidhur me agjencitë doganore, që është edhe një proces i filluar paraprakisht.

Sipas draftmarrëveshjes, është krijuar edhe struktura, Komiteti i Ekspertëve, e cila do të ngarkohet me monitorimin e kësaj marrëveshjeje dhe palët do të lidhin protokolle të veçanta për bashkëpunime specifike dhe teknike sipas nevojës në zbatim të kësaj marrëveshjeje.

Është e rëndësishme të theksohet se gjatë importit, eksportit dhe transitit, mallrat do të trajtohen me të njëjtat procedura dhe të njëjtat pasoja ligjore sikurse do të ishin në territorin e palës tjetër. Kontrollat doganore do të mbështeten në bazë të metodave elektronike të shkëmbimit të riskut.

Vlen të theksohet që shkëmbimi i informacionit për risqet dhe rezultatet e analizave të riskut ndërmjet administratës doganore të të dyja palëve do të vendoset sipas standardeve dhe kritereve të përbashkëta të riskut.

Gjithashtu, dëshiroj të theksoj, për efekt të prezantimit, që në zbatim të kësaj marrëveshjeje parashikohet të hartohen protokolle të veçanta ndërmjet autoriteteve kompetente shtetërore të palëve për të përcaktuar më hollësisht procedurat e bashkëpunimit.

Marrëveshja qeveritare është nënshkruar në mbledhjen e përbashkët të qeverive në fund të vitit të kaluar në Elbasan dhe ju paraqitet sot për miratim.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja Dyrmishi, sepse, në fakt, ishit shteruese në prezantimin e projektligjit!

Fjalën e ka kolegu Klosi, në cilësinë e relatorit.

Blendi Klosi – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, besoj që projektligji në fjalë do të gjejë konsensusin e të gjithë komisionit dhe më gjerë se kaq, të të gjithë parlamentit shqiptar, pasi vjen në vazhden e një sërë marrëveshjesh që ne po kalojmë tani në këtë komision dhe pastaj në seancë, që janë në rrjedhën e punës së bërë ndërmjet të dyja qeverive, asaj të Shqipërisë dhe asaj të Kosovës në

vazhdimësi, pra edhe në ndryshim ministrash, në ndryshim edhe titullarësh, por politikat vazhdojnë të jenë të njëjtat dhe përsëri ky projektligj vjen si një kërkesë e kohës për të lehtësuar gjithnjë e më shumë procedurat në kufirin ndërmjet dy anëve të Bjeshkëve. Në rastin konkret bëhet fjalë për procedurat doganore dhe të kontrollit të hyrje-daljes së mallrave në kufirin ndërmjet dy vendeve ose dy anëve të Bjeshkëve përsëri.

Pra, projektligji vjen si një dakordësi e dy qeverive tona. Nuk ka efekte shtesë në buxhetin e shtetit, por vjen si një lehtësi në këtë menaxhim dhe ku qeveritë apo administratat marrin përsipër të ndihmojnë njëra-tjetrën në procedurat doganore, duke lehtësuar kalimin e mallrave në kufi, ku edhe ato çfarë do të duhet të bëjnë strukturat doganore, ashtu siç edhe projektligji e parashikon, do të jenë në kostot e vendeve respektive, por që nuk do të ndikojnë në vlera të mëdha në buxhetin e shtetit.

Javën e kaluar në komision kaluam një projektligj, i cili kishte të bënte qartësisht me lëvizjen e lirë të qytetarëve, ndërsa sot po flasim për mallrat, pra duke lehtësuar hap pas hapi të gjitha procedurat e nevojshme në komunikimin ndërmjet popullsisë në të dyja anët e Bjeshkëve.

Besoj që kam të drejtën t'i kërkoj komisionit dakordësinë për këtë projektligj, natyrisht me diskutimet përkatëse, por nuk dyshoj në votën unanime pro këtij projektligji.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Klosi!

Shikoj që ka ardhur zëvendësministri Kadia.

Mirë se vini, zëvendësministër! Nëse keni diçka për të shtuar, mund ta merrni fjalën. Nëse jo, e hap tryezën për pyetje dhe diskutime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem! Jeni i mirëkuptuar!

Po, zoti Xhafaj, fjala për ju.

Etjen Xhafaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Shumë faleminderit edhe zotit Klosi për relatimin, si dhe stafit të Ministrisë së Financave!

Absolutisht, të gjithë ne këtu e mbështesim.

Kam një pyetje për zonjën Dyrmishi për sa i përket të gjithë anës procedurale, sidomos për kontrollet *a posteriori*, pra nëse në këtë moment kemi një rakordim dhe në qoftë se mund t'i shpjegohet këtij komisioni, duke qenë se ka një interes, sidomos duke konsideruar edhe zhvillimet më të fundit dhe problematikat që kanë lidhje me disa nga mallrat, sidomos me ato që janë tituj akcize.

Mund të na bëni një shpjegim, pra për sa u përket kontrolleve *a posteriori*, që nga plumbosja në portin e Durrësit dhe deri në fund?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Xhafaj!

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Po, zoti Çollaku.

Kreshnik Çollaku – Më shumë se pyetje, e kam sugjerim, por edhe informuese.

Patjetër, po i përgjigjem edhe zotit Klosi, vota ime është totalisht në mbështetje të këtij projektligji dhe si çdo nismë që shkon në përafrim me mbështetjen, në bashkëpunim me Kosovën, mendimi dhe sugjerimi është që kjo është një gjë për t'u përshëndetur patjetër, por realisht, të jem krejt i sinqertë, më duket që një nismë, një projekt i tillë mund të ishte i vlefshëm edhe në një vend tjetër dhe përsëri do të ishte për t'u përshëndetur.

Çështja është që Kosova për ne ka një peshë specifike, qoftë edhe në kuptimin konkret, sepse bëhet fjalë për një territor kufitar me Republikën e Shqipërisë, ka afri kulturore, është i njëjti komb, e njëjta gjuhë, lehtësi ndaj bizneseve...

Pra, unë do ta konceptoja si një zonë të përbashkët ekonomike të të dyja vendeve dhe mendoj që në këtë lloj statusi të veçantë, që nga pikëpamja e procedurave shtetërore mund t'i ndjekin procedurat e detyrueshme ndërkombëtare, por në pikëpamjen psikologjike Kosova e ka një status të veçantë në raport me Shqipërinë dhe këto dy hapësira, këto dy ekonomi duhet... Nuk ka asgjë të keqe të fillojmë t'i rikonceptojmë si ekonomi të përbashkëta.

Në këtë pikëpamje, a ka hapësira të tjera, që të tilla marrëveshje, të tilla lehtësi dhe të tilla mbështetje të thellohen më tej? E mbështes këtë që keni sjellë, por po ju pyes: në këtë koncept, a ka hapësirë që kjo të zgjerohet, që kjo të shtrihet, që ta përfshijë të gjithë lehtësinë dhe unifikimin, si të themi, të të dyja ekonomive tona?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Çollaku!

Po, zoti Shehu.

Tritan Shehu – Jo, unë nuk kam asgjë të gjatë për të thënë, por vetëm se jam dakord me këtë nismë, me këtë marrëveshje që duhet të ratifikohet.

Marrëveshjet nuk kanë ndonjë gjë, ratifikohen siç janë. Kështu që nuk kam as çfarë të shtoj, as çfarë të heq nga kjo, se ndryshe pastaj...

Jam dakord krejt.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Ju falënderoj për bashkëpunimin!

Zëvendësministër, do ta merrni ju fjalën për përgjigjet, apo zonja Dyrmishi? Si të doni.

Atëherë, zonja Dyrmishi, fjala për ju.

Arjana Dyrmishi – Lidhur me çështjen e kontrolleve *a posteriori*, të cilat janë kontrolle pasi ka mbaruar procedura e zhdoganimit, jo vetëm për mallrat subjekt i akcizës, por për çfarëdolloj malli, janë pjesë e procedurave të brendshme që ndjek çdo administratë doganore në bazë të kriterëve të riskut që ka.

Pra, secila palë, dhe në rastin konkret administrata doganore shqiptare dhe ajo kosovare, ndjekin procedurat e tyre të kontrollit *a posteriori* në bazë të analizës së riskut.

Ndërkohë, mendoj që te pjesa e kontrolleve dhe e problematikave që kanë dalë gjatë diskutimeve që ne kemi pasur në takimet e përbashkëta kanë qenë çështjet e peshimit të dyfishtë, të cilat janë ndjekur kryesisht nga pala kosovare; kanë qenë çështjet e kohës së pritjes në Vërmicë kryesisht, si dhe problemet e funksionimit të pjesës së transitit.

Më lejoni, zoti deputet, që, duke ju dhënë përgjigje për këtë gjë, të ezauroj edhe përgjigjen ndaj pyetjes së deputetit tjetër.

Marrëveshja, që ne sot ju paraqesim për miratim, është marrëveshja e cila detajon dhe thëllon nivelin e bashkëpunimit jo për krijimin e një zone ekonomike, le të themi, por për thjeshtimin në minimizim zero të bashkëpunimit doganor.

Pavarësisht nga elementet patriotike, si afërsia me Kosovën e të tjera, duhet theksuar që Kosovën ne e kemi edhe një partner të rëndësishëm tregtar, sepse në nivelin e marrëveshjeve të CEFTA-s mbi 54% të eksporteve i kemi drejt Kosovës. Pra, ka një interes të shtuar të partneritetit mes dy palëve për të rritur këtë potencial.

Është filluar para katër vjetësh me transitin. Është hapur një zyrë doganore e palës kosovare në Porto Romano, me zyrë dhe me staf, madje kemi edhe dhënien e aksesit në sistemet ASYCUDA. Më duhet të them që edhe agjentët doganorë të palës kosovare janë pjesë e sistemit ASYCUDA, njihen dhe shihen nga administrata doganore. Pra, ky bashkëpunim është thelluar.

Në lidhje me pjesën e peshimeve të dyfishta, janë udhëzuar degët doganore, sepse janë nën tagrin e kontrollit doganor që në pikat kufitare me Kosovën të eliminohet peshimi i dyfishtë. Problematikat kanë të bëjnë me pjesën e kontrollit të përbashkët dhe të riskut.

Në muajin nëntor të vitit të kaluar administratat tona doganore nënshkruan së bashku procedurat e kontrollit të përbashkët në pikën doganore të Vërmicës.

Pra, janë një set masash që ne i kemi marrë në bashkëpunim me administratën doganore kosovare si në nivel administratash, ashtu edhe në nivel qeverish, për t'i thjeshtuar dhe për t'i eliminuar sa më shumë këto barriera që kemi mes vendeve. Kryesisht barrierat janë të natyrave të ndryshme, të cilat vijnë sipas operatorëve të ndryshëm.

Në qoftë se do të flasim për pjesën e karburanteve, që e përmendi deputeti, për pjesën e karburanteve veçantia qëndron te deklaratat e thjeshtuara. Me Kodin Doganor kemi mundësinë... Domethënë, mund të jetë shumë teknike. Mund të bëhen deklarata për çfarëdolloj ngarkese, ndërkohë që me Kodin Doganor ne aplikojmë edhe te deklarata përmbledhëse, e cila është deklaratë e thjeshtuar. Ndërsa pala kosovare deklarimin e thjeshtuar e ka me autorizim.

Ne kemi rakorduar me homologët doganorë të palës kosovare për të bërë *awareness* të përbashkët mes bizneseve për të përdorur këtë lehtësi që ka Kodi ynë Doganor, në mënyrë që të bëjnë deklarata të thjeshtuara, të cilat eliminojnë edhe kohën, edhe kostot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Zoti Çollaku, shtesë në komentin tuaj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Dyrmishi, keni mbaruar?

Kreshnik Çollaku – Jo, ishte shumë e qartë, vetëm kam një pyetje.

Unë e kuptova dhe absolutisht e mirëkuptoj këtë gjë, madje, ndjesë, nëse nuk jam shumë i informuar në planin më konkret të financave.

Ajo çfarë unë dua të kuptoj është kjo: një biznes, një shtetas i regjistruar i Kosovës, po themi, një operator ekonomik, në qoftë se do të zhvillojë një aktivitet ekonomik-tregtar në Shqipëri, trajtohet i njëjtë si çdokush tjetër, si çdo shtetas i huaj tjetër, që regjistrohet në Republikën e Shqipërisë, apo ka një mundësi...? Pra, në rast se ka një hapësirë për të krijuar një mundësi më privilegjuese, nëse është e mundur apo jo. Domethënë, nuk po pyes në kuptimin e kritikës, por më shumë në atë informues. Në rast se është e mundur, a mund të ofrohen këto? A ka një mundësi që këtyre operatorëve t'u jepet një lehtësim më i madh, duke qenë se kemi këtë afri që thashë? Është më shumë e karakterit informues...

Mimi Kodheli – Po, zonja Dyrmishi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka ndonjë koment tjetër, apo...

Arjana Dyrmishi – Është e qartë.

Mimi Kodheli – Ju lutem! Fjalën e jap unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tjetër koment?

Arjana Dyrmishi – Është e qartë.

Mimi Kodheli – Zonja Dyrmishi, ju lutem, mbylleni mikrofonin, se ka një koment zoti Koçi dhe pastaj do t'jua jap fjalën ju.

Petro Koçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, sigurisht, shpreh mbështetjen time totale për këtë projekt marrëveshje, e cila dëshmon edhe një herë marrëdhëniet e privileguara që ka Shqipëria me Kosovën dhe janë marrëdhënie, që besoj se edhe me këtë marrëveshje, thellohen më tej. Madje, këtë duhet ta themi hapur, sepse nuk kemi asnjë arsye që ta themi ndryshe, në mënyrë më të moderuar apo më diplomatike.

Ndërkohë, dua të bëj edhe një lloj pyetjeje. Ju thatë që në rastin e zbatimit të marrëveshjeve të mëparshme, është dashur që administratat doganore reciproke kanë bërë edhe marrëveshje të tjera konkrete. Tani, në zbatim të kësaj marrëveshjeje të re, që pritet të ratifikojë, besoj në 100% të votave, parlamenti, do të duhet sërish të kenë marrëveshje administratat doganore në zbatim të marrëveshjes?

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Tjetër? Nuk ka.

Zonja Dyrmishi.

Arjana Dyrmishi – Lidhur me pyetjen e parë, më duhet ta ndaj në dy kategori. Në momentin kur një kompani kosovare ushtron aktivitetin e saj në Republikën e Shqipërisë, ajo trajtohet njëlloj sikurse çdo kompani tjetër italiane e të tjera, për arsye se Shqipëria, me anëtarësimin nga viti 2000 në Organizatën Botërore të Tregtisë dhe në marrëveshjet e tregtisë së lirë që ka, zbaton parimin e mosdiskriminimit mes bizneseve. Pra, i njëjti trajtim që i bëhet një biznesi kosovar, ofrohet edhe për të gjitha vendet e tjera.

Cili është dallimi që ne ofrojmë përmes kësaj marrëveshjeje? Dallimi qëndron te procedurat doganore që do të kryejë një operator kosovar. I ka më të lehtësuara në bashkëpunim. Administratat tona doganore operojnë më ngushtësisht për të thjeshtuar, për të eliminuar kohën e kryerjes së procedurave të zhdoganimit.

Pra, në momentin kur do të hapet, për shembull, një pikë doganore e Kosovës diku në Fier, e cila do të bëjë aty procedurën e zhdoganimit të frutave-perimeve të zonës, bën të gjithë procedurën në Fier ose në Lushnjë, ku e vendos, dhe malli konsiderohet i eksportuar në Kosovë. Pra, ka të bëjë me pjesën e procedurës dhe jo me pjesët e së drejtës së hapjes së një biznesi, normave tarifore, që janë njësoj për të gjitha.

Për këtë arsye ne kemi ardhur në parlament për këtë marrëveshje.

Marrëveshjet e tjera, të cilat i ka pasur administrata jonë doganore me palën kosovare, janë dy marrëveshje mes dy vendeve që, në bazë të Kodit Doganor, në bazë të tërësisë, operojnë dy administrata doganore për kontrollet e përbashkëta, për analizat e riskut, për thjeshtimin... Me vendim të Këshillit të Ministrave është miratuar edhe funksionimi i zyrës së transitit të Kosovës.

Ndërsa për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, që do të miratohet nga parlamenti, do të lidhen protokolle të tjera të veçanta mes administratave doganore në funksion të zbatimit të kësaj marrëveshjeje, për të cilën nuk është e nevojshme të jenë pjesë e kësaj shtojce ose të vijnë sërish në parlament, sepse janë shumë teknike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Ju faleminderit!

Gjykoj që duhet ta hedhim në votim, meqenëse zonja Dyrmishi dhe zotërinjtë deputetë ishin shterues lidhur me shpjegimet.

Ju falënderoj për bashkëpunimin, të nderuar kolegë!

E hedhim në votim në parim projektligjin.

Kush është dakord në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Shikoj se jemi të gjithë dakord.

Miratohet.

Vazhdojmë me votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord?

E konsideroj të miratuar.

Neni 2. Kush është dakord?

Edhe një herë, ju lutem, votojmë projektligjin në tërësi. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 9.3.2022, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile dhe tregtare” (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Etjen Xhafaj, Petro Koçi, Besion Ajazi, Benet Beci, Tomor Alizoti, Hatixhe Konomi, Lavdrim Krashi, Tritan Shehu, Ilirjan Pendavinji, Belind Këlliçi, Kreshnik Çollaku, Blendi Klosi dhe Greta Bardeli.

Mungojnë:

Blendi Klosi, Grida Duma, Alqi Bllako, Shpëtim Idrizi, Klodiana Spahiu dhe Vangjel Dule.

Të ftuar:

Klajd Karameta – Zëvendësministër i Drejtësisë.

Besmir Beja – Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë.

Diana Stillo – Eksperte Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë.

Mimi Kodheli – Kalojmë te projektligji i dytë, për shkak të nevojës së regjistrimit të procesverbalit, e ricitoj projektligjin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të vijë dikush tjetër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ah, do të kemi përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë.

Kërkoj ndjesë!

Atëherë, zoti zëvendësministër, zonja të nderuara dhe zotërinj, ju falënderoj për prezencën dhe punë të mbarë!

Suksese!

Shpresoj të shihemi shpejt.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ricitoj projektligjin e dytë: “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile dhe tregtare”, për të cilin jemi komision për dhënie mendimi dhe relator do të jetë kolegu Beci.

Të pranishëm kemi zotërinjtë Karameta, zëvendësministër e Drejtësisë, dhe Beja, si dhe zonjën Stillo. Jam saktë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë se vini në komision!

Zoti Karameta, fjala për ju.

Klajdi Karameta – Faleminderit, zonja kryetare!

Kërkoj ndjesë për zërin, jam pak i ftohur!

E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Ratifikimi i marrëveshjes që kemi sot përpara mbështetet në ligjin nr. 43 të vitit 2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Ai është detyrim ligjor që bën të mundur përfundimin e procesit sipas legjislacionit në fuqi. Konkretisht, pas miratimit në parim (që është akti me anën e të cilit Këshilli i Ministrave ka miratuar këtë marrëveshje para nënshkrimit), me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1027, datë 16.12.2020 “Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për ndihmë të ndërsjellë

juridike në çështjet civile dhe tregtare” marrëveshja është nënshkruar nga palët në datën 26.11.2021.

Në këto kushte, bazuar në nenin 17 të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, për të realizuar përfundimin e këtij procesi paraqesim për miratim propozimin për ratifikimin e marrëveshjes në fjalë.

Marrëveshja e sipërpërmendur është e strukturuar në katër pjesë organike.

Në pjesën e parë përcaktohen klauzolat e përgjithshme.

Në pjesën e dytë parashikohen procedurat e dhënies juridike.

Pjesa e tretë përfshin rregullat mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe të arbitrazhit, si dhe procedurën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Ndërkohë, pjesa e katërt përfshin dispozitat përfundimtare me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ku parashikohet zgjidhja e çështjeve nëpërmjet rrugëve diplomatike ose nëpërmjet komunikimit ndërmjet autoriteteve qëndrore të palëve sipas legjislacionit të tyre të brendshëm. Nga ana e përmbajtjes, marrëveshja zbatohet për çështjet civile dhe tregtare, që përfshin procedurat lidhur me gjendjen civile, çështjet familjare, marrëdhëniet e punës, çështjet e pronësisë, trashëgiminë dhe marrëdhëniet e tjera civile ose tregtare të personave fizikë dhe juridikë, përveç rasteve të përjashtuara shprehimisht nga marrëveshja.

Mimi Kodheli – Zoti Karameta, ju kërkoj ndjesë që ju ndërpres!

Ne e kemi relacionin përpara. Dy fjalë shteruese se ku konsiston marrëveshja.

Jeni i falur për zërin, e rëndësishme është të mos keni Covid, për të tjerat jeni më shumë sesa i falur.

Klajd Karameta – Jo, Covid nuk kam, se e kam kaluar.

Mimi Kodheli – Realisht, vetëm dy fjalë.

Klajd Karameta – Atëherë, marrëveshja zgjidh bashkëpunimin gjyqësor...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, me dy fjalë marrëveshja parashikon zgjidhjen e çështjeve gjyqësore ndërmjet dy vendeve tona, Kosovës dhe Shqipërisë; lehtëson bashkëpunimin e ndërsjellë, çështjet juridike të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë në fushën civile, sepse në fushën penale ekziston tashmë një bashkëpunim, është e konsultuar edhe me Ministrinë e Jashtme dhe me Ministrinë e Financave, ka marrë dakordësinë në parim nga të dyja ministritë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Ju falënderoj!

Kolegu Beci, fjala për ju!

Benet Beci – Faleminderit, e nderuar kryetare!

Të nderuar kolegë,

Siç e prezantoi edhe zëvendësministri, qëllimi i ratifikimit të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës është fillimi i këtij ligji. Marrëveshja është miratuar në parim me vendimin nr. 1027, datë 16 dhjetor 2020 nga Këshilli i Ministrave dhe është nënshkruar nga palët më 26 nëntor të vitit të kaluar.

Kjo është një marrëveshje që zbatohet për çështje civile dhe tregtare, që përfshin procedurat që lidhen me gjendjen civile, çështjet familjare, marrëdhëniet e punës, çështjet e pronësisë, trashëgiminë dhe marrëdhëniet e tjera civile ose tregtare të personave fizikë dhe juridikë, përveç rasteve të përjashtuara shprehimisht nga kjo marrëveshje.

Risi në këtë marrëveshje është garantimi i të drejtës së shtetasve për qasje të lirë pranë gjykatave dhe i të drejtës së dhënies së ndihmës juridike falas.

Kjo marrëveshje e propozuar për ratifikim përmban gjithsej 23 nene dhe 4 kapituj. Vlen për t'u theksuar që ky projektligj nuk sjell efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit. Çdo kosto e mundshme do të përballohet brenda tavaneve të miratuara për institucionet përkatëse, të ngarkuara me zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Për sa më sipër, i ftoj edhe kolegët ta mbështesin dhe ta votojnë pozitivisht këtë projektligj.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Ju faleminderit për prezantimin!

A ka pyetje? Nuk besoj se ka.

Dakord, meqë nuk kemi pyetje dhe komente, shumëçka e konsumuam edhe me diskutimin e projektligjit, pa e lidhur me projekt marrëveshjet midis Republikës së Shqipërisë dhe asaj të Kosovës, mendoj ta hedhim në votim.

Kush është dakord me ratifikimin e kësaj marrëveshjeje?

Jemi të gjithë dakord. Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1, ju lutem! Ju faleminderit!

Miratohet.

Neni 2, edhe 1 herë, ju lutem!

Edhe njëherë në tërësi ligjin, ju lutem! Kundër? Abstenim?

Miratohet me të gjitha votat tona.

Faleminderit, kolegë për prezencën!

Punë të mbarë!

Të shkuara, Zëvendësministër!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 9.3.2022, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e pjesëshme të zgjeruar për rrugët kulturore, miratuar me rezolutën CM/RES (2013) 66". (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Etjen Xhafaj, Petro Koçi, Besion Ajazi, Benet Beci, Tomor Alizoti, Hatixhe Konomi, Lavdrim Krashi, Tritan Shehu, Ilirjan Pendavinji, Belind Këlliçi, Kreshnik Çollaku, Blendi Klosi dhe Greta Bardeli

Mungojnë:

Blendi Klosi, Grida Duma, Alqi Bllako, Shpëtim Idrizi, Klodiana Spahiu dhe Vangjel Dule

Të ftuar:

Meri Kumbe - Zëvendësministre e Kulturës

Anila Muka - Drejtore e Drejtorisë së Integritimit në Ministrinë e Kulturës

Mimi Kodheli - Kalojmë te projektligji i tretë: "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e pjesshme të zgjeruar për rrugët kulturore, miratuar me rezolutën CM/RES (2013) 66".

Jemi komision për dhënie mendimi.

Kolegu Krrashi referon.

Të ftuar kemi zonjën Kumbe, zëvendësministre e Kulturës dhe zonjën Muka, drejtore e Drejtorisë së Integritimit.

Mirë së vini, zonja të nderuara!

Zëvendësministre, 2 fjalë për projektligjin.

Faleminderit!

Fjala për ju.

Meri Kumbe – Përshëndetje!

Faleminderit!

Ky projektligj mbështetet në nenin 81, pika 1 dhe, neni 100, të Kushtetutës dhe është në përputhje me ligjin nr. 43, të vitit 2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë".

Shqipëria ka marrë angazhime për të qenë pjesë e këtij programi duke dërguar letrën e shprehjes së interesit për aderim, drejtuar sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Marrëveshja e pjesshme e zgjeruar për rrugët kulturore aktualisht përbëhet nga 36 shtete anëtare dhe Shqipëria do të marrë pjesë si vend i aderuar. Siç përcaktohet nga rezoluta CM/RES e vitit 2013/ 66 e Këshillit Europian, Këshilli i Ministrave, në datën 2 shkurt 2022 ka miratuar projektvendimin dhe ky projektligj është në përputhje me programin e Ministrisë së Kulturës.

Nëse më lejoni, do të them shumë pak fjalë për programin "Rrugët e kulturës". Bashkimi Europian prej disa vitesh tashmë ka certifikuar disa rrugë në Europë, që lidhen kryesisht me tematika, për shembull, një prej rrugëve, që prek Shqipërinë është rruga "Pemët e ullirit".

Ne detyrohemi të paguajmë një tarifë hyrëse prej 5300 eurosh dhe kjo do t'i jepte mundësinë pushtetit lokal dhe të gjithë operatorëve që operojnë në terren, pikërisht në ato zona gjeografike ku përcaktohen rrugët, për t'u bërë pjesë dhe për të aplikuar në një sërë grantesh, që hapen nga Bashkimi Europian.

Mendojmë se është shumë e rëndësishme për ne, sepse jep jo vetëm vizibilitet sa i përket turizmit kulturor, por është një mundësi e mirë për të ndihmuar të gjitha bizneset

lokale dhe pushtetin vendor për të pasur mundësi të rritur, lidhur me promovimin e vendeve të tyre.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja Zëvendësministre!

T’ju them të drejtën kjo çështja e “Rrugëve të ullirit”, nuk e kisha menduar ndonjëherë, më duket shumë intriguese. Pasi i dogjëm dhe i premë të gjithë ullinjtë shekullorë të Shqipërisë, për arsye që s’është e nevojshme t’i përmendim, u rikthehemi prapë rrugëve të ullirit. Së pari, ulliri simbolizon paqen dhe, e dyta, është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka të bëjë me karmën. Patjetër që kthehet, shpresoj shumë të jetë kështu.

Atëherë, kolegu Krrashi, fjala për ju.

Lavdrim Krrashi – Faleminderit për prezantimin!

Për projektligjin "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e pjesshme të zgjeruar për rrugët kulturore, miratuar me rezolutën CM/RES (2013) 66", përveç atyre që ju thatë, e nderuar, unë dua të them vetëm 2 fjalë.

Përmes miratimit të kësaj marrëveshjeje ne rrisim mundësinë e shkëmbimit kulturor të vendit tonë me vendet e tjera, jo vetëm në rajon dhe në Europë, por edhe më tej dhe kjo është për t’u përshëndetur, sepse fuqia e një shoqërie matet me diversitetin që ajo krijon. Kështu që, shkëmbimi kulturor do të jetë i dyanshëm, jo vetëm i njëanshëm, pra jo vetëm promovimi i kulturës shqiptare në vendet e tjera, por edhe promovimi i kulturave të tjera në vendin tonë. Kjo do ta bëjë shoqërinë edhe më fleksibël, edhe më diverse dhe rrjedhimisht edhe më të fortë, prandaj mua nuk më mbetet gjë tjetër veçse t’ju lutem dhe t’ju kërkoj të gjithë kolegëve ta miratojnë këtë marrëveshje.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Atëherë, zoti Çollaku ka një pyetje?

Kush kishte pyetje tjetër?

Patjetër, zoti Këlliçi ka një pyetje.

Fjalën e ka zoti Çollaku.

Kreshnik Çollaku – Në parim unë jam absolutisht dakord dhe e përshëndes, madje e mbështes edhe fjalën tuaj, ngjan intriguese, por do të dua të kuptoj, me gjithë përpjekjen time, 3 herë që e lexoj se: çfarë do të thoni në përmbledhjen shpjeguese të përmbajtjes, ku flisni për dimension demokratik të shkëmbimit të kulturor dhe të turizmit? Nëse mundet të jepni një shtesë komenti.

Mimi Kodheli – Duhet të jetë një përkthim *mot`a mot*.

Lavdrim Krrashi – Këtë doja të thosha. Këto fraza parazitare nuk i bëjmë ne, duhet të fillojmë të mësojmë të shprehemi pak më mirë.

Mimi Kodheli – Intriguese, ta fusim në fjalor.

Lavdrim Krrashi – Një gjuhëtar mund ta bëjë këtë, ka të drejtë ta bëjë.

Mimi Kodheli – Patjetër ka të drejtë.

Zoti Belind Këlliçi, fjala për ju.

Belind Këlliçi – Faleminderit, kryetare!

Përpos shpjegimit që kërkoi zoti Çollaku, unë dëgjova shumë fjalë të bukura këtu, por gjëja e fundit që mund të flitet në Ministrinë e Kulturës, gjykoj unë, është ruajtja e trashëgimisë kulturore. Me sa shoh projektligji ka për qëllim të kontribuojë në promovimin e identitetit dhe qytetarisë europiane, nëpërmjet njohjes së ndërgjegjësimit për trashëgiminë e përbashkët të Europës, dhe marrëveshja synon të krijojë një hapësirë të përbashkët kulturore nëpërmjet zhvillimit të rrugëve kulturore, që synojnë të nxisin ndërgjegjësimin për trashëgiminë kulturore. Domethënë, nëse ka një aspekt, unë gjykoj që Ministria e Kulturës është totalisht e dështuar në këto vite, është shkatërrimi që i ka bërë identitetit tonë kulturor në Shqipëri, trashëgimisë kulturore, mbi të gjitha, masakrës që është bërë në kryeqytet.

Në dijeninë time, në vitet e fundit, dhe më korrigjoni nëse e kam gabim, Ministria e Kulturës ka kontribuar për heqjen nga lista të një sërë objektsh dhe monumentesh të trashëgimisë kulturore në kryeqytet, për t'i hapur rrugë ndërtimit të gradaçelave dhe kullave në qendër të Tiranës. Unë po flas për Tiranën, sepse jam banor i këtij qyteti dhe, për hir të së vërtetës, nuk do të doja të isha pjesë e një mbledhjeje, ku flitet për marrëveshje aderimi në organizata ndërkombëtare. Ne flasim bukur në letër, por konkretisht në produkt ne kurrë nuk bëjmë *delivery* dhe nuk jemi të sigurtë dhe të vërtetë.

Nëse ka një problem sot kryeqyteti i Shqipërisë, është që ka humbur identitetin e tij, ka humbur simbolet e tij, ka humbur rrugicat e tij, ka humbur gjithçka që e ka identifikuar këtë qytet në të paktën 200 apo 300 vjetët e fundit. Kështu që, për sa kohë ministria juaj, unë gjykoj, ka dështuar në mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore të kryeqytetit tonë, unë nuk e di sesi ju mund të kontribuoni në ruajtjen dhe trashëgiminë e identitetit europian. Ne me të vërtetë ndodhemi gjeografikisht në qendër të Europës, si vend, por për sa i përket këtij aspekti unë gjykoj që Ministria e Kulturës duhet të ndihet me shumë faj në këto vite për atë çka i ka shkaktuar kryeqytetit dhe të gjithë vendit në tërësi, por në mënyrë të veçantë kryeqytetit.

E them këtë sepse, sigurisht që nuk keni lidhje me ndërtimet në Tiranë dhe me lejet e ndërtimit, por për t'u hapur rrugë lejeve të ndërtimit dhe pastrimit të parave në Tiranë,

sigurisht është dashur që një sërë shtëpish të vjetra monumentesh të vjetra, të hiqen nga lista e monumenteve, që janë nën mbrojtjen e shtetit, për shkak se janë monumente të trashëgimisë kulturore të kategorive të ndryshme, për t'i hapur rrugë më pas shkatërrimit të këtyre objekteve identitare të kryeqytetit, për të ndërtuar mostra betoni.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Këlliçi!

Përpara se t'ju jap fjalën, Zëvendësministre, unë kam një pyetje dhe një koment.

E para, dua të di: pse quhet marrëveshje e pjesshme e zgjeruar? Kjo është thjesht për saktësim.

E dyta, komenti im është: ky projektligj vjen në Komisionin për Politikën e Jashtme për të vërtetuar, për të marrë votën tonë, që kjo marrëveshje, ky aderim është në përputhje të plotë me aderimin dhe marrëveshjet ku Shqipëria ka firmosur, bën pjesë dhe nuk ka asgjë në kundërshtim me të gjitha marrëveshjet ku Shqipëria bën pjesë ose organizmat ku Shqipëria bën pjesë. Thënë kjo, pavarësisht të gjithë të drejtës që ka çdo deputet i Kuvendit të Shqipërisë, për të bërë komentet, është në të drejtën e secilit prej nesh.

Kolegë, dua t'ju rikujtoj se ministria ka një përfaqësues politik, që është ministri, i cili mund të thirret në çdo moment në seancë pyetjesh, dëgjësash dhe në mocion me debat për çdo gjë që shqetëson çdo banor të Tiranës dhe çdo përfaqësues të votuesve të Tiranës.

Kështu që, zoti Këlliçi, ju ftoj ta bëni këtë dhe ne të mund të vazhdojmë me diskutimin për aderimin e Shqipërisë në këtë marrëveshje dhe të mirat që sjell ajo. Kjo nuk e kundërshton këtë tjetrën, ashtu siç diskutimi i rëndësishëm që mund të bëjmë në lidhje me çfarë ju thatë dhe shqetësimet që keni, na bën të mos e diskutojmë dhe të mos e miratojmë këtë projektligj sot.

Zëvendësministre, fjala është për ju.

Meri Kumbi – Faleminderit, kryetare!

Faleminderit edhe për pyetjet!

Duke e nisur nga pyetja e fundit se përse quhet marrëveshje e pjesshme, ky është emri që i ka vënë vetë komisioni, sepse ka shumë zona, nuk është vetëm Bashkimi Europian, janë vendet candidate, është dhe zona e vendeve baltike, pra është shumë më e gjerë.

Për sa u përket komenteve...

(Zonja Mimi Kodheli flet pa mikrofon)

Po, me pyetjet.

(Zonja Mimi Kodheli flet pa mikrofon)

Në fakt, doja të nënvizoja vetëm një detaj në lidhje me përkthimin dhe me përdorimin e gjuhës shqipe, pra përkthen nga përkthyesit zyrtarë. Patjetër që do ta kemi në konsideratë dhe do të përmirësohemi ndjeshëm për ta pasur kujdes këtë.

Për sa u përket pyetjeve për trashëgiminë kulturore, mendoj se Shqipëria ka punuar shumë vitet e fundit, si rrallëherë. Jemi në vitin me më shumë kantiere të hapura për sa i përket restaurimit dhe rijetëzimit të trashëgimisë kulturore. Sjell në vëmendjen tuaj fondin prej 40 milionë eurosh të EU4Culture dhe një sërë nismash të tjera.

Për sa i përket trashëgimisë kulturore jomateriale, që prek më së shumti ky program ose ndryshe atë që e quajmë trashëgimi të gjallë, vetëm vitin e fundit Ministria e Kulturës ka aplikuar 4 dosje drejt UNESCO-s. Në 20 vjetët e fundit kemi vetëm një dukuri të nënshkruar.

Thënë kjo, shumë shkurtimisht, për t'iu përgjigjur shqetësimeve tuaja në lidhje me punën tonë, patjetër që prioritet është ruajtja, por ruajtja nuk është një proces konservimi vetëm në vetvete, por është dhe rijetëzim. Ne jemi duke punuar me partnerët më të mirë dhe me eksperiencat më të mira europiane, falë dhe mbështetjes nga Bashkimi Europian.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zëvendësministre!

Fjalën e ka nënkryetari Alizoti.

Tomor Alizoti – Zonjë e nderuar, konkretisht, se ju thatë që keni çuar dosje në OKB. Kultura është diçka që jeton...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndjesë, sepse na rri mendja tek Ukraina!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Se edhe Shqipëria si Ukraina ka përfunduar me këto.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka përfunduar, duke parë... Në histori apo në këto gjëra nuk ka më, ka vetëm rindërtime, por ne jse.

Konkretisht, çfarë janë objektet? Se objektet janë gjëra të gjalla, që i shikojnë njerëzit.

Ju, si Ministri e Kulturës, çfarë keni ruajtur konkretisht?

Cilat janë këto objekte për të cilat keni marrë miratimin nga OKB-ja, siç e thashë?

Mimi Kodheli – Jo, zëvendësministre, fjalën jua jap unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Këllici.

Belind Këlliçi - Ideja është e tillë: unë e kuptoj dhe shpeshherë ne jemi shumë të mirë për të prodhuar dokumente, për të prodhuar letra, për të aplikuar në projekte, por nëse ka në gjë që ju nuk e mohoni dot dhe që është fakt, është fakti që në këta 8 vjet numri i objekteve që kanë qenë pjesë e trashëgimisë kulturore, në listën e trashëgimisë kulturore të kategorive të ndryshme, në të gjithë Shqipërinë, por kryesisht në kryeqytet, është më i lartë se 30 vjet të marrë së bashku. Kjo ka një arsye dhe ka të bëjë me politikën e kësaj qeverie për të mos e pasur aspak prioritet trashëgiminë kulturore.

Tani, në momentin kur ne nuk jemi të zotë t'i dalim për zot historisë dhe trashëgimisë sonë si qytetarë dhe si shqiptarë, si mund të kontribuojmë në ruajtjen e trashëgimisë dhe identitetit europian, kur ne jemi shembulli më i keq në Ballkan, në rajon e më gjerë?! Ky është shqetësimi im.

Pra, çfarë vlere të shtuar sjellim ne me këtë marrëveshje, me këtë ratifikim në këtë organizatë, kur unë nuk e di se si na kanë pranuar?! Si ka mundësi që na kanë lejuar për të aplikuar për t'u bërë pjesë?! Si është e mundur kjo?! Kjo më habit!

Po e them edhe një herë, zonja zëvendësministre, është e pamundur që ju të bëni avokatinë dhe t'u dilni për zot politikave tuaja për trashëgiminë kulturore në Ministrinë e Kulturës në këta 8 vjet. Kjo është absurde! Unë nuk e di se ku mund ta gjejë një zyrtar i këtij shteti aftësinë për t'i dalë për zot asaj që ka ndodhur në Tiranë dhe në Shqipëri.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Këlliçi!

Me siguri kanë gjetur ndonjë mik atje, që ia ka mundur këtë gjë Shqipërisë! Nëse është kështu, kanë bërë shumë mirë.

Kolegë deputetë, ju rikujtoj që është në të drejtën tuaj, pse jo, edhe në detyrimin tonë, të dërgojmë një letër me kërkesa pranë institucionit që zonjat përfaqësojnë, duke filluar që nga pyetja e nënkryetarit Alizoti e deri te pyetjet e kolegut Këlliçi. Të dërgojmë pyetjet brenda një afati kohor ligjor të arsyeshëm. Zonja, jeni të lutura dhe të detyruara të ktheni përgjigje lidhur me listat, me çfarë kemi në ruajtje, në çfarë procesesh jeni për të... Mund të ketë pyetje nga më të ndryshmet, *site* të ndryshme, të cilat mund...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ose duhet të marrin dhe duhet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pikërisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, zoti Alizoti.

Atëherë, ju lutem, zonjat nuk janë kompjuterë, që ti i jep *search* dhe të del!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe sikur ta dinë.

Zonjat kanë ardhur këtu për një projektligj të përcaktuar. Ose do t'u japim kohë zonjave dhe ato do të rikthen pas gjysmë ore, pasi të kenë marrë informacionin e duhur, që përgjigjja të jetë e saktë dhe të mos jetë sporadike, se nuk e kanë përpara këtë material, ose do t'i zyrtarizojmë kërkesat tona dhe, pasi ta kemi bërë këtë, do të marrim përgjigje zyrtarisht. Mund t'i rikthejmë edhe një herë zonjat dhe t'u themi: “Shikoni, ne kemi këtë shqetësim”. Mund të thërrasim edhe ministren për këtë, nuk kam asnjë problem, realisht. Përkundrazi, po ju them edhe një herë që është në detyrimin dhe në të drejtën tonë ta bëjmë këtë sa herë që ka një shqetësim të drejtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Absolutisht po, se do të bënim një diskutim sipërfaqësor, do të bënim një diskutim të mangët. Edhe pyetja është pjesore, edhe përgjigjja, për pasojë, do të ishte pjesore dhe e mangët, jo për shkak të zonjave, por për shkak të momentit, se ne nuk po pyesim për çfarë jemi duke diskutuar sot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo pastaj është...

Nëse keni diçka për të cilën, në dijeninë tuaj, mund t'u përgjigjeni kolegëve, ne jemi më shumë se të lumtur. Përndryshe, ju ftoj ta bëjmë seriozisht këtë që thashë.

Po, zonja zëvendësministre.

Meri Kumba – Faleminderit, zonja kryetare!

Për sa u përket listave që ju referuat, më lejoni t'ju sjell në vëmendje se UNESCO është e ndarë në dy kategori, në trashëgiminë materiale dhe jomateriale. Unë fola për listën e trashëgimisë jomateriale, ku Shqipëria vite më parë ka futur vetëm isopolifoninë, që është e regjistruar. Përgjatë periudhës së pandemisë, Ministria e Kulturës ka punuar me katër aplikime të tjera dhe i pesti është në proces. Kemi dërguar xhubletën në listën e ruajtjes urgjente, për të ngritur dhe kapacitetet për planin e ruajtjes afatmesëm dhe afatgjatë. Kemi dukurinë e transhumancës, e cila është dukuri e shtegimit të bagëtive, që po shkon përpara me Francën, Spanjën, Luksemburgun dhe Rumaninë. Është e regjistruar aktualisht nga Austria, Greqia dhe Italia dhe jemi duke u asistuar nga të gjithë këto shtete. Kjo lidhet pikërisht edhe me këtë program, sepse është një ndër rrugët e ardhshme të Europës dhe këtu kemi të bëjmë dhe me dijetërbërjen e produkteve organike, siç njihen sot në kohët moderne. Dosja e tretë është “Kcimi i Tropojës”, e cila është depozituar *gia* në UNESCO dhe jemi duke pritur një përgjigje për të. Kemi dhe dosjen e katërt të Eposit të Kreshnikëve. Ndërkohë,

jemi duke punuar për “Motin e madh” me komunitetin arbëresh, si një thirrje ndërkombëtare me shtetin italian. Këto ishin sa i përket listës së trashëgimisë jomateriale.

Për sa i përket listës së trashëgimisë materiale, e cila është një listë më vete, një kategori më vete dhe nuk preket detyrimisht nga ky projektligj që kemi sjellë, ne kemi të regjistruar aty qytetet, që ju i dini, si: Gjirokastra, Berati, Butrinti dhe jemi duke punuar për Durrësin. Ndërkohë, kemi çuar përpara dhe Ohrin te zonat e mbrojtura.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit për informacionin, zëvendësministre! E vlerësoj.

Zoti Koçi, keni pyetje, komente apo të dyja bashkë?

Petro Koçi – Kam një koment dhe ndoshta do t’ju mundoj pak në kohë për të sqaruar diçka.

Mimi Kodheli – Ju, në mënyrë të veçantë, asnjëherë!

Petro Koçi – Unë i bashkohem shqetësimit qytetar lidhur me trashëgiminë tonë. Ky proces i integritetit, po themi, i globalizimit, në njëfarë mënyrë, është një rrezik asimilimi në përgjithësi. Në kuptimin qytetar, bashkohem me çdo lloj shqetësimi, pavarësisht dimensionit dhe retorikave politike, që nganjëherë na nxisin ose na motivojnë edhe për t’u keqkuptuar. Në këtë kuptim, i bashkohem, po themi, thelbit të shqetësimit, por mendoj se kjo marrëveshje nuk është se e rrezikon trashëgiminë tonë apo identitetin tonë kulturor. Unë besoj më shumë se është një marrëveshje që e nxit këtë gjë dhe sidomos na nxit në standardet europiane të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Në nenin 1, pika 2, po ta lexojmë me kujdes, e gjejmë shumë qartë këtë gjë dhe besoj se shuajmë çdo lloj shqetësimi apo merakun në lidhje me marrëveshjen.

Tjetra që dua të them është që, sigurisht, ne jemi parlamentarë, jemi përfaqësues të popullit apo të komunitetit të qarqeve nga të cilat vijmë dhe kemi një sërë shqetësimesh, por këtu jemi në Komisionin e Politikës së Jashtme. Mendoj se përgjithësisht diskutimet tona duhet të përqendrohen te ky dimension ose te detyrat funksionale që ka komisioni ynë. Sigurisht që edhe çështjet kulturore ose politikat kulturore mund të kthehen në politika të jashtme, por nëse ka merake që lidhen me gjëra konkrete, kam përshtypjen se duhet të shfrytëzojmë mekanizmat dhe instrumentet e tjera parlamentare për të gjetur përgjigje apo dhe për të nxitur iniciative që, si të thuash, përballojnë dhe u japin zgjidhje shqetësimeve tona. Kaq kisha. E mbështes projekt marrëveshjen.

Mimi Kodheli - Faleminderit kolegut Koçi!

Nëse nuk ka komente të tjera, mendoj ta hedhim në votim. Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Abstenim? Zoti Këlliçi abstenon.

Faleminderit!

Miratohet.

Neni 1. 1 abstenim.

Neni 2.

Miratohet.

Votojmë në tërësi projektligjin.

Ju falënderoj shumë për bashkëpunimin, kolegë të nderuar, sidomos kolegët e opozitës!

Zonja të nderuara, faleminderit për prezencën! Faleminderit për të gjithë informacionin që dhatë!

Edhe një herë, kolegë, çdo kërkesë, për të cilën mund të mundësojmë një informacion më të detajuar nga Ministria e Kulturës, jeni të lutur ta bëni.

Punë të mbarë!

Rishihemi në mbledhjen e ardhshme.

Shihemi nesër në seancë.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA